

KËRKIME GJUHËSORE

Aida LAMAJ (ÇUNI)

TË FOLURIT FEMËROR DHE RITUALI I MORTIT

ABSTRACT. *Death is an inevitable phenomenon in our life, in the same way are also the ritual of death accompanied by the dirge and the keening performed by men. Keening is a phenomenon common among all peoples, the instances in which the ritual of death and keening coincide, as a special phenomenon of its, are numerous given the fact that keening is an outcome of an extremely special emotional state. However, even during the ritual of death every people tries to display through words its qualities, a multitude of characteristics preserved and transmitted with fanaticism from one generation to the other.*

The ritual of death constitutes an important element of our tradition and at the same time a material always interesting to be studied in minute details. In this study we have tried to limit ourselves to the feminine speech, since keening, in general in our country has been carried out by women.

Differences and similarities among keening on the national scale, from the diachronic and synchronic point of view, can be seen clearly if we compare the Albanian creations in different regions. The similarities and differences within the Albanian culture serve as a typical paradigm to study how the ancient elements of outlook that the Albanians have had on death, history, and the social organization in these regions have been preserved and transmitted and above all, in what way these feelings have been clothed from the linguistic point of view, the typologies of keening and of all of the ritual of death, which clearly shows archaic forms as well as new developments. The study has encompassed the popular lyric poetry as well as new entries, whereas from the geographic point of view we focus mainly in the Southern regions, although examples from other regions where Albanian speaking people live are also present.

Key words: feminine speech, ritual of death, the typologies of keening, linguistic characteristics of the dirge.

Gjuha dhe kultura është një dikotomi e vëzhguar që herët në gjuhësinë amerikane, europiane, por nuk mungojnë perceptimet për të edhe në gjuhësinë shqiptare. Duke e menduar, gjuhën, të folurit si zbulues të mënyrës së jetesës së një grupi shoqëror të caktuar, studimet e kërkimet moderne iu afruan trajektoreve biologjike, sociale e kulturore të seksit femëror.

Në këtë hulli nuk u la jashtë vëmendjes kodi etik i grupimeve femërore të Ballkanit. Teza të ndryshme pohuan të vërtetën se seksi femëror i shoqëron kodet, traditat kulturore e etnografike, mentalitetin mesdhetar me fjalë të zgjedhura, shprehje metaforike, urime, mallkime, por edhe me sintagma e tekste që “të drithërojnë” trupin e shpirtin. Gjithë shkrimtaria etnolinguistike ka marrë parasysh faktin se femra shqiptare është shumë e ndjeshme. Ajo preket nga lindja e një fëmije të shumëpritur, nga një fejesë e vonuar, nga humbja e një personi të dashur etj. Kjo ndjeshmëri e brendshme e ka bërë atë që të shtojë fjalët e të zgjerojë repertorin e

vet, sa me të drejtë thuhet se këto konvencione përjetimi e diturie “*rrjedhin vetë nga goja e folësve*”.

Në ligjërimin shqip paraqiten si dukuri interesante perceptimet, përjetimet e formësimet stilistike që përcjellin dhimbje e ngushëllime, testamente për një nga çastet më të dhimbshme: vdekjen. Ajo është një proces i vështirë, por në të njëjtën kohë edhe kompleks, ku ndërthuren dhimbja për personin e dashur, dashuria dhe nostalgjia për momentet e kaluara me të, shpresa se atje ku do të shkojë do të gjejë paqe etj. Aq sa e madhe është bota shpirtërore e gruas, aq e madhe është dhe moria e shprehjeve të këtyre ndjenjave me mjete jo vetëm paralingvistike (mimika, gjestet, lëvizja e duarve e trupit etj.), por edhe me fjalë që burojnë nga skutat më të thella të shpirtit. Ky “prushërim” magjik, emocionor e shumëthënës ka vite që na ka nxitur të lexojmë e mbledhim një lëndë të gjerë leksiko-sintaksore, duke mëtuar që sot në këtë takim shkencor të shpërfaqim vetëm disa nga tiparet e strukturës, të kodimit psikologjik e lingistik të të folurit femëror.

Edhe pse është një moment i dhimbshëm, vaji në trevat tona është pjesa kryesore e ceremonialit të vdekjes dhe mbart një trashëgimi të lashtë të botëkuptimit që të parët tanë kanë patur për vdekjen. Ai paraqitet i ndërthurur ngushtë me historinë e popullit tonë dhe shpërfaq po aq sa çdo ceremoni tjetër jo vetëm folklorin, besëtytnitë, por edhe jetën shoqërore të shqiptarëve në epoka të ndryshme. Të gjitha trevat e Shqipërisë, ku vajza, motra, nëna, gruaja perceptohen si më të tronditurat, *kanë rregullat e tyre të pashkruara që shoqërojnë ritin e mortit*. Kur një njeri është në prag të vdekjes, rreth tij ulen të gjithë të afërmit në pritje të momentit të kobshëm. Ka raste kur agonja e të sëmurit zgjat më tepër se normalja e atëherë, një prej grave (e shoqja, e motra etj.), falë shprehjeve: *O Zot merre, O Zot ndihmoje, Mos e lër të vuaj!!* etj., i kërkon zotit ta ndihmojë.

Shpesh herë me **dashamirësi i sëmuri “qortohet” që po e mundon veten**. Tek gratë e trevave të Jugut ekziston një besëtytni, që i sëmuri ka frikë të shkojë tek një botë të cilën nuk e njohim, p.sh. në një rast kur i sëmuri është në çastet e fundit, gruaja e tij i nxjerr të gjithë të afërmit jashtë (ndoshta se ka turp të shprehet lirshëm në praninë e tyre dhe i thotë bashkëshortit se tani ai duhet të shkojë, në atë botë do të jetë shumë mirë, se tashmë i ka takuar për herë të fundit fëmijët, i premton se do t’i qëndrojë pranë në çdo moment, madje do të kujdeset për të deri në fund (edhe pasi të vdesë).

Në zonën e Labërisë, kryesisht **në banorët e besimit bektashian**, në momente të tilla, poshtë jastëkut të të sëmurit vihet një teslim (është një objekt prej fildishi ose qelibari, i cili pasi është “kënduar” nga një hoxhë shërben si një mjet i shenjtë). Të krishterët e të gjitha trevave, gjatë këtyre momenteve ndezin një qiri i cili fiket menjëherë sapo jeta e të sëmurit shuhet. Me gjithë rëndësinë që merr çdo moment gjatë përjetimit të mortit në një shtëpi dhe përgatitjet që i bëhen të ndjerit për ta përcjellë dhe për t’u ndarë përgjithmonë nga kjo jetë, **vaji është një nga momentet kulmore të këtij ceremoniali**, i cili nuk kalon pa vënë re dhe jo pak herë është bërë objekt studimi dhe diskutimi (ndonjëherë ka shërbyer edhe si

TË FOLURIT FEMËROR DHE RITUALI I MORTIT

frymëzim për poezi¹). Sipas prof. Çabejt, në vajet shqiptare ndeshim një krehje a lënim të gjuhës, fjalë të zgjedhura dhe “një trill poetik të madhnueshëm”².

Rituali i vajeve është i larmishëm edhe në raportet ***që ekzistojnë mes prindërve dhe fëmijëve***. Kështu, e mbetur e vetme përballë babait që ka vuajtur për një kohë të gjatë, e bija jo vetëm kujdeset për babanë, pasi nëna dhe një pjesë e vëllezërve kanë vdekur, por e vendos të sëmurin në pozicionin ulur dhe me disa shprehje e inkurajon të mos ketë frikë për çka e pret: *mos ki frikë se atje do të gjesh Lalanë* (është emri i së shoqes), *mos të të vijë rëndë o Zot, dil o shpirt se atje po të presin fëmijët, se atje është më mirë* etj. Sapo i sëmuri jep shpirt ose i del shpirti më të dashurit e tij e qajnë me lot e me fjalë.

Duke bërë një përjasje *mes vajit që shpërndan seksi mashkullor* me atë të seksit tjetër, vërejmë se burrat në përgjithësi rrinë të heshtur e të vrenjtur, tymosin sa më shumë duhan, por ndonjëherë, për pak momente, ndeshim edhe vajin e tij me fjalët: *i ziu unë, i shkreti unë, ku më le* etj. (vaji nga Kukësi). Ndryshe ndodh, kur vdes një pjesëtar mashkull i familjes. Është gruaja, e cila mbart një të folur të kujdesshëm, me dridhje të zërit, me frymëmarrje të çregullt e të vështirë, ku balli mbulohet nga djersa e ligjërimi ndërpritet nga pashtrmat *ah, oh, uh, bubu, medet, korba, e zeza, derëzeza*, ose nga disa të qeshura nervoze që risjellin ndërmend kujtimin e ditëve kur babai, vëllai, burri, fëmija, trimi ishin gjallë. Heshtjen e burrave, e thyen qarja me fjalë e grave. Ato shfaqen shpesh me sintagmat e frazat: *e zeza unë, korba unë, si më le të vetme me një tufë - bark fëmijë, e mjera unë* etj. Edhe gjatë procesit të larjes dhe të veshjes së të ndjerit gruaja vazhdon të qajë me fjalë, kjo për arsye se kur lajmi të përhapet dhe të afërmit të vijnë, ajo do ta qajë vetëm me lot e psherëtimë e rrallëherë me fjalë të shqiptuara nëpër dhëmbë.

Gratë e moshuara e kanë për turp ta qajnë me fjalë bashkëshortin e tyre. Në vend të saj këtë e bëjnë motrat ose vajzat e të ndjerit. I ndjeri vendoset në një dhomë në pozicionin me kokë nga perëndimi (simbolizon perëndimin e shpirtit), dhe rreth tij mblidhen të gjitha gratë. Vajtimi me ligje në përgjithësi është një përshkrim i momenteve më të rëndësishme të jetës së të ndjerit duke i përmendur gjithashtu edhe paraardhësit që e presin në atë botë. Shpesh midis vajit të ndjerit i jepen “porosi” të flasë me X-in ose Y-nin, që e pret në atë botë.

Të vjelësh botën shpirtërore të dikujt në një moment delikat siç është të shprehurit me anë të vajit të dhimbjes për humbjen e të dashurit, është tejet e vështirë, por jo e pamundur. Femra si “personazhi” kryesor i këtij rituali ka detyrën kryesore të hapjes së vajit dhe si një regjisore e vërtetë kujdeset që asnjë detaj të mos harrohet. Vajin e hap personi më i afërt i të ndjerit dhe pothuaj në të gjitha trevat niset me një përshkrim të gjendjes në të cilën i ndjeri i ka lënë të afërmit. Që këtu fillojnë e shpalosen një sërë figurash, si: similituda, epitete, krahasime etj., që i bën vetes një grua e lënduar nga një humbje. Në lirikën popullore shprehjet më të përdorura janë: *e mjera unë, korba, mandilzeza katra*,

¹ Gj. Shkurtaj, *Etnografi e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2004, f. 62.

² E. Çabej, *Studime gjuhësore*, V, Zakone dhe doke të shqiptarëve, Prishtinë, f. 196.

burgateshë, cullufeprepera, qyqe, zemëramavria, kallogreja, leshërazeza, e gjora unë, derëzeza, zemërpërvëluara, kërcure, e shkretë etj.

Vaji mbart vlerat e një rrëfimi të ngjashëm me një kronikë, ku qartazi bëhen të njohura të gjitha etapat shoqërore nëpër të cilat ka kaluar cikli jetësor i të ndjerit.³ Kjo nuk është tipike e lirikës popullore, por rastet në të cilat haset, janë të shumta...⁴ Edhe në gjatë studimit të disa rasteve e kemi hasur dendur një dukuri të tillë. Pothuaj në të gjitha trevat, vaji **nis me një “qortim”** ndaj të ndjerit: *Diqe e pse kaqe shpejt? / Ç’u dhiase e shkove?...⁵*

Me një **lëvdim të tipareve më të mira** të të ndjerit ose mënyrës se si ka humbur jetën trimi: *Ke kanë, or vlla, shumë burrë i majrë, or vlla!...⁶ / Ani, mor Selman, të ka motra vlllo, / ani, se me pushkë, vlllo të paskan vro...⁷*

Duke i kërkuar një fjalë të fundit: */ Falu e përfalu, o baba em, / me gjem e me re, o baba em! / Fal e beko, or baba em, me hanë e me diell, or baba em, / me hanë e me ill, or baba em!⁸*

Duke i kujtuar **ngjarje të së shkuarës** që nuk mund të përsëriten më: *A e ma men kur shkojshim te tutë, oj gjrue bre,...⁹*

Në lirikën tonë popullore një vend shumë të rëndësishëm zënë vajet me tematikën e nizamit dhe të kurbetit, ku qartazi bëhet e njohur ngjarja dhe jo ndjenja që ka shkaktuar ngjarja dhe rezultati është sërisht trishtim dhe lot:

...rrodhën sytë lotë sa ka kroi ujë plotë / S’mu ktheve dot, u derëzeza

/ Bir-o të pret nëna, grua, jua, parmenda.¹⁰ (Tepelenë)

S’kam un’kujt t’i qajë halle, / mbeçë vetëm pa një djalë, / mbeçë vetëm nënë e shkretë...¹¹ (Sinicë, Korçë)

Hallet e dertet e mia, m’i di zemëra mavria / Hapu moj zemër e shkretë, hapu bënu fletë-fletë / Të dalin o marazetë...¹² (Vuno, Vlorë)

Burrë lumi, burrë deti, / vate në kurbet e mbeti / të mjerën mua ç’më gjeti!¹³ (Zhej, Gjirokastrë)

kërcure që rri në vatër, kërcure pa asnjëri / si kalon këtë zoi, me lot me paraponi...¹⁴ (Vlorë)

Vajet njihen për karakterin e tyre improvizues dhe shpesh herë mënyra e të vajtuarit përbën një etalon vlerësimi **për reputacionin** e një gruaje, por ndodh edhe e kundërta. Ja një rast nga Libofsha e Fierit, ku vaji merr formën e një

³ Shih. A.Bellusci, *Ricerche e studi tra gli arberori dell’Ellade*, Cosenza, 1994, f. 130, 423.

⁴ Lirika popullore 1, f. 18.

⁵ Dh.S. Shuteriqi, Mbledhës të folklorit, *Nga kënga e popullit* 9, Tiranë, f. 573-577.

⁶ Sh. Hoxha, Mbledhës të folklorit, *Lirikë popullore nga rrethi i Kukësit*, f. 333.

⁷ Sh. Hoxha, Mbledhës të folklorit, *Lirikë popullore nga rrethi i Kukësit*, f. 330.

⁸ Sh. Hoxha, Mbledhës të folklorit, *Lirikë popullore nga rrethi i Kukësit*, f. 333.

⁹ Sh. Hoxha, Mbledhës të folklorit, *Lirikë popullore nga rrethi i Kukësit*, f. 337.

¹⁰ Lirika popullore 3, f. 383.

¹¹ Lirika popullore 3, f. 428.

¹² Lirika popullore 3, f. 381.

¹³ Lirika popullore 3, f. 458.

¹⁴ Lirika popullore 3, f. 536.

TË FOLURIT FEMËROR DHE RITUALI I MORTIT

bashkëbisedimi të kujdesshëm ku përmenden emra dhe merret radha e të vajtuarit sipas një rendi të mirëpërcaktuar:

E madhja e shtëpisë:

...pa dëgjo Rrapi të keqen-o / ti s'dëgjon, as keq s'të vjen, / na ike, na i ktheve krahët djalit /ose djemve, / na ike, na i ktheve krahët çupave, / na ike, na i ktheve krahët nipërve / na ike, na i ktheve krahët mbesave, etj. (pra, duhen përmendur djemtë të parët.)

Mozaiku ligjërimor me ngjyime e emocione tronditëse **shpesh u është drejtuar konvencioneve virtuale** që lidhen me zotin e besimin fetar. Kështu, në të gjithë Shqipërinë, pavarësisht njohurive të pakta fetare që kanë mbetur nga një periudhë e gjatë 50-vjeçare në një sistem të rreptë ateist, gjithsesi njerëzit nuk kanë reshtur së menduari se ekziston një botë e përtejme. Pikërisht, për këtë të ndjerit i jepet një sapun, para, libra dhe sende të tjera personale, të cilat do t'i nevojiten.

Në ditët e sotme edhe **bashkëshortja mund të qajë bashkëshortin** e saj. Vargjet variojnë që nga “qortimi” për faktin se e ka lënë pas, kujtimet dhe hallët që kanë kaluar dhe që kanë ndarë së bashku. Çdo varg përfundon me një fjalë të vetme që mund të jetë: *korba unë, e zeza, e shkreta unë* etj.

Në rastet e vdekjes së një të riu e sidomos të një fëmije është e vështirë të përcjellësh fjalët që thuhet për të, sidomos të nënës, madje, sipas grave labe të kujtosh e të përmendësh fjalët e një nëne të traumatizuar, në një moment të tillë, është kaq e rëndë sa mund të sjellë ters ose gjynah. Ato, tek flasin, lëvizin nga vendi ku janë ulur, sepse kështu e largojnë të keqen atje ku është. Dendur haset shprehja “atje qoftë” kur bisedon me to për tema të tilla. Fjalët që përmend një nënë gjatë vajtimit të një fëmije, janë nga më të ndjerat dhe më të fortat emocionalisht. Nëna ka të drejtë të qajë për minuta të tëra, por jo pa kufi. Kështu, një tekst me strukturë poetike që përcjell kujtesën e jetës shkollë si një mjet ngushëllimi, na tregon se vajtorja për të shkaktuar dhembje ekspresive tek prindërit i percepton anët e jashtme të inventarit të shkollës, tekstet e shkollës dhe vetëdijen e nënës, që bëhen me anë të organeve të shqisave: *"More Pashko kokrra e molla / Ëj hëë...ëj / Të rrin çperast banka e shkolla /I kujtohen librat ç'ke lan / Ëj hëë...ëj"*

Ligjërimi femëror përcillet sipas përkatësisë së interpretueseve, lidhjeve të gjakut a qumështit që ka pjesëmarrësja me individin që nuk jeton. Për sa i përket grave që vijnë të shohin meitin - xhenazënë (të vdekurin), ato mund të qajnë me fjalë nëse e kanë fituar një status të tillë që t'ua lejojë këtë veprim. Ndër shprehjet që përdoren për të ngushëlluar gruan (personat) janë: *Të rroni vetë, të të rrojë fëmija, bëj durim, s'ke ç'i bën, si gjithë të tjerët, s'je as e para e as e fundit* etj. Nëse vdekja ka qenë për shkaqe natyrore ose sëmundje e rëndë tek një person shumë i moshuar, të afërmve të tij u thuhet: *iku tëk- tëk, shpëtoi, na la, e mori Zoti* etj. Më pas gjatë rrugës për në banesën e fundit qahet vetëm me lot e rrallë me fjalë, veç në rastet e një humbjeje shumë të rëndë. Pasi i ndjeri është varrosur gjatë kthimit në shtëpi nuk qahet më me fjalë pasi është gjynah (mëkat) sepse ka hyrë akshami (pasdite, nga turqishtja).

Karakteristikë për myslimanët në këto treva gjatë këtyre ceremonive është gatimi i hallvës, e cila shpërndahet tek të gjithë, shoqërohet me shprehjet ngushëlluese: *të rroni vetë, i/e paharruar qoftë, u trettë si sheqeri etj.* Ndërkohë që të krishterët/kaurët kanë zakon gatimin e grurit me sheqer. Të gjithë të pranishmit duhet të hanë një lugë të tillë dhe duhet të thonë shprehjen: *iu ndihetë shpirti në paqe.*¹⁵

Në ditët e sotme shumë prej këtyre traditave dhe fjalët që i shoqërojnë ato kanë ardhur duke u zbehur, në mos kanë humbur fare. Shumë prej grave të reja nuk dinë të qajnë me ligje, njëkohësisht edhe formulat e ngushëllimit kanë pësuar rrafshim, në përgjithësi përdoren vetëm shprehjet: *të rroni vetë dhe ngushëllime.*

Duke lexuar vëmendshëm ligjërimin femëror, nuk mund të anashkalosh mënyrën se si strukturohen e sendërtohen semantikisht dhe formalisht vajet. Nga lënda e vjelë vërejmë:

Vaje që nisin me një “ftesë” drejtuar maleve, brinjave, qyteteve, fshatrave, të afërmeve për t’iu bashkuar ceremonialit dhe dhënies së lamtumirës të ndjerit: *Qani, qani o male/ qaj Gjirokastër mavria/; qaj o Kardhiqi në brinjë/ nëno moj, vajto moj/ ; Delvinë, e zeza Delvinë, pse s’vure ulërimë/ qaj o Nivicë mavria/ ...etj.*

Vaje që nisin me një përshkrim të koordinatave kohore apo hapësinore, brenda të cilave ka ndodhur largimi nga jeta: *Pasdreke, dit’ e xhuma/të mërkurë atë ditë/ të djelë në të gdhirë...etj.*

Vaje që nisin me një thirrje të të ndjerit (shpesh e shoqëruar nga një cilësor) për të dëgjuar fjalët e fundit dhe për të ndjerë deri në fund dhimbjen që ka lënë pas largimi: *O Kutia ime melaqe/ Pilo zemëra ç’më le/ jelekkuqi kadife/ Asllan Gjoçë Kapetani/ Haxhire, moj motër-e ...etj.*

Nga pikëpamja leksikore vajet paraqesin një ndërthurje të fjalorit bazë të gjuhës shqipe me krahinorizma, huazime, kryesisht turqizma dhe greqizma, kjo si pasojë e një kontakti të gjatë dhe të vazhdueshëm me këto gjuhë, si dhe një marrëdhënieje të hershme gjuhësore, kulturore dhe njerëzore: Kështu shprehjet dhe sintagmat e këtij ligjërimi përmbajnë: turqizmat *haber, hade, mushavere, vezir, hazine, derexhe, cangadhe, sevda, iftira, ilaka, katërngar, koshallë, xhelepçinj, suvarinë, vali, tabor, uxhum, xhuma*, etj. e greqizmat *manile, kallogre, jatri, ormis, paraponi, zoi* etj.

Së fundi, është e nevojshme të përmendim se vajtimi si një lloj “komunikimi” i veçantë na mundëson të hedhim dritë :

1. Për përdorimin social të përemrave vetorë e kallëzuesve – foljorë përkatës. Kështu, në rastet e një vajtimi më intim, ku folësi femëror i drejtohet drejtpërsëdrejti të ndjerit, përdoren folje në vetën e dytë njëjës: *jetënë s’e trashëgove/T’rriti nëna ty, barkun that’, o bir/ Të vran’, o Sihat, të vranë në Nivicë më të dalë* etj; folje në vetën e tretë njëjës e të dytë shumës kur hapet vaji në një mjedis më të gjerë: *qani me lot papushuar/ Dhe ju mesa e stërmesa prisni kosa, hiqni tela, hidhni manile të zeza ati e në shtatë breza/ ; Plakat po të lajnë,*

¹⁵ Shih Gj. Shkutaj, vep. cit. 2004.

shoqet po të qajnë, bir, moj çupkë e nënës, dymbëdhjetë plagë etj. ku duket se çdo pjesëmarrës ka një pjesë dhe rol të caktuar në ceremoni.

2. Për moshën, seksin e marrëdhëniet dhe statusin shoqëror të të ndjerit: *E mirë e purtekë e artë, moj faqebardhë si kartë/, moj çupkë e nënës, nga shoqet m'e mirë/ më shkove në mosh' të re, më shkove me shpirt të djegur për një djalë, për një çupë.../ e madhja kunata jonë, të kishim fjalë e kuvend, kë do gjejm' tani në kënd/ diq Idriz zëmërë shkëmi, sa lezet të kish kuvëni/ Jelekuqi kadife, me njëmijë dhën kope/ një predhë të bëri çikë, re në lulen e rinisë, etj.*

3. Për përdorimin e regjistrave të ndryshëm krahinorë e dialektorë etj: *bir, moj çupkë e nënës, lezet i shtëpisë/ ashtu si kishe hadenë, të mëledhç mushaverenë/ O Kutia im melaqe rahmet paç atje tek re/ n'atë jet', n'atë دنیا, gazi u këput e ra posi illi në saba/ Motër, qaj me derexhe/ Zero Lonari u vra, për një fjalë iftira. Lanet pastë kush e tha: Shanija me ilaka, etj.*

Nga sa përshkruam më sipër, mund të përfundojmë se: kodimi psikologjik e lingvistik i të folurit femëror në ligjërimin shqip paraqet perceptime, përjetime e formësime stilistike që përcjellin gjithë gamën e ndjenjave për një nga çastet më të dhimbshëm: vdekjen dhe dëshmojnë për një begati e larushi formash leksikore e gramatikore që më besnikërisht se kudo tjetër paraqesin mendësinë dhe etnosin e trashëguar ndër shekuj në këto treva.

Pothuajse në të gjitha vajet paraqitet një strukturë e veçantë e cila nis me një ftesë drejtuar subjekteve frymore dhe jofrymore e më pas vaji bëhet më intim dhe i ngjason një përshkrimi deri në detajet më të holla të të ndjerit me anë të kompozitave, cilësorëve, etj., nga të cilët mund të vilen regjistra krahinor, dialektor e huazime pa fund, të cilët përbëjnë një thesar të paçmuar për gjuhën shqipe.

Improvizimi, shpesh përziejhet me rregulla e ligje të pashkruara, të cilat u japin karakter mistik vajeve. Gjuha shqipe, pjesë e pandashme e një zhvillimi më të gjerë shoqëror që synon përherë e më shumë drejt globalizimit, po pëson pashmangshmërisht mjaft bjerre të këtij ligjërimi kaq të veçantë, megjithatë duke ruajtur përherë të paprekur lidhjet “gjenetike” me historinë tonë.

BIBLIOGRAFI

- Çabej, E. Zakone dhe doke të shqiptarëve. *Studime gjuhësore*, V. Prishtinë.
Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i kulturës popullore, *Këngë polifonike labe*, Tiranë, 1986.
Kondi, M. *Këngë popullore nga rrethina e Kardhiqit dhe e Rrëzomës* Mbledhës të folklorit 5, Tiranë, 1987.
Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i kulturës popullore, *Këngë popullore të rrethit të Korçës*, Tiranë, 1982.
Gj. Shkurtaj, *Etnografi e të folurit të shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2004.
Bellusci, A. *Ricerche e studi tra gli arberori dell'Ellade*, Centro ricerche socio-culturali “G. Castriota”, Cosenza, 1994.
Lirika popullore 1-4.
Dh. S. Shuteriqi, *Nga kënga e popullit*, Mbledhës të folklorit 9.
Hoxha, Sh., *Lirikë popullore nga rrethi i Kukësit* Mbledhës të folklorit 5.